



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 03-03/DPK	Nr. Prot. 01-1895/16
Dep. 02	Br. Prot. 01-1895/16
Nr. i faq.	Prot No.
Broj stranica	Data
Nr. pages	Date 27-05-2016



Republika e Kosovës SHITINË

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	27/05/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/1813/16
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ Zyra e Prokurimit – K.K Prizren
CC:	z. Ramadan MUJA Kryetar Komune – K.K Prizren
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Renovimi i Shtëpisë së malorëve në Kopanavodë (uji ngrouar) faza dytë”

I nderuar z. OSMANKAJ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nën par. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nën par. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nën par. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Renovimi i Shtëpisë së malorëve në Kopanavodë (uji ngrouar) faza dytë” me numër prokurimi: 622/16/082/521”, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Renovimi i Shtëpisë së malorëve në Kopanavodë (uji ngrouar) faza dytë” me numër prokurimi: 622/16/082/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna Prizren keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: “Renovimi i Shtëpisë së malorëve në Kopanavodë (uji ngrouar) faza dytë” me numër prokurimi: 622/16/082/521, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 06/05/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për punë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Njoftim për Kontratë, tek pika II.2) SASIA APO FUSHVEPRIMI I KONTRATËS, është kërkuar: ***Vërejtje të gjitha materialet e përdorura duhet të jenë prej të njëjtit prodhues (KNAUF); në një pozicion në rubrikën e njëjtë është kërkuar: Furnizimi transportimi dhe montimi i dyerve prej drurit te hapësirat e brendshme prodhim slloven; po ashtu në pozicionin e radhësh kërkohet: Furnizimi transportimi dhe montimi i dritareve prej drurit apo PWC e ngjyrosur të elaksuar prodhim slloven me strukturë druri. Këto kërkesa janë edhe në para masë dhe para llogari. Në para masë dhe para llogari të dosjes së tenderit tek NDRIQUESIT janë kërkuar: a) PA-15 me poqe të zakonshëm 60W-40W “EMPA” dhe c) Drita akumuluese FSN 100-16 LP16W prodh. “ El Kovina” Maribor. Të gjithë këta artikuj të lartë përmendur, janë kërkuar llojet e produkteve dhe vendi i origjinës. Autoriteti kontraktues nuk duhet të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.*

Tutje, bazuar në legjislacionet në fuqi për prokurim publik me përcaktimin e llojit të prodhimit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, evropian ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkohet emërtimi i të këtyre furnizimeve.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !